

**STATUT E AKTHEMELIMI I
SHOQËRISE TREGTARE
“Yes Red Group” SH.P.K**

Kreu I

Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia

Neni 1:

Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

Sot, më 01/05/2023 (dymijë e njëzete tre), ne, themeluesit, kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin “Yes Red Group” SH.P.K.

Themeluesi i shoqërisë është:

Z.Pulici Paolo, lindur në datë 15.05.1969 , në Desio/ Itali, madhor e me zotësi të plotë juridike për të vepruar , mbajtës i kartës së identitetit Italiane Nr. CA59673NJ .

Me vullnet të lirë të plotë si themeluesi i kësaj shoqërie në të cilën është ortak vendos të hartojë këtë Statut e Akt Themelimi mbështetur në nenet e mëposhtme si dhe në dispozitat ligjore si :

Kodin Civil

LIGJIN ME NR 9901 DATË 14.04.2008 ”PËR TREGTARËT DHE SHOQËRITË TREGTARE”

Neni 2:

Objekti

Te ofroje sherbime e konsulence, studime tregu, zhvillues software programim, assistance informatike dhe marketing on line.

Komercializimi i software; Konsulence per projektimin dhe menaxhimin e platformave dixhitale; Pergatitja dhe furnizimit direkte dhe indirekte e IT, sherbimeve telematike, marketing, trajnimit te integruar me mbeshtetje logjistike per zhvillimin e tregtise tradicionale dhe elektronike se cdo aktivitet, nepermjet internetit rrjete te tjera kompjuterike, si dhe nepermjet kanaleve tradicionale.

Prodhimi dhe instalimi u shenjave dhe paisjeve te ndryshme elektrike


Prodhimi I artikujve te letres dhe kartonit

Fotopunime per riperpunim dhe printim si dhe te gjitha aktivitetet qe lidhen apo jane te nevojshme per zbatimin e qellimit te kompanise.

Stampim dhe instalim te materialeve adesive, prejen dhe kartoteknika

Promovim per iniciativat e aktiviteve tregtare, industriale; Studime tregu ne lidhje me aktivitetet prodhuese te mallrave dhe / ose sherbimeve; Ofrimi i informacioneve te ndryshme per biznesin; Monitorimi dhe perkrahje i iniciativave te biznesit; Ofron sherbime per drejtimin, nxitjen dhe zhvillimin e biznesit; Ofron sherbime administrative, teknike, komerciale dhe financiare; Asistenca teknike dhe financiare per kompanite ne marrjen e kredive dhe / ose grante ne lidhje me fonde kombetare apo te BE-se;

Ofron sherbime per te optimizuar menaxhimin e kompanive, organizatave, shoqatave dhe korporatave, nepermjet konsulences per organizimin, ristrukturimin, kontabilitetin, planifikimit financiar, kontrollin e kostos, sasine dhe cilesine e prodhimit, koordinim teknike logjistik, tregtar, financiar, analiza e riskut te biznesit (menaxhimi i riskut); Sherbime informative, konsulence dhe mbeshtetje te biznesit per rekrutimin dhe perdorimin me te mire te burimeve financiare; Konsulence per financat e korporatave dhe mbeshtetje ne zgjedhjet strategjike te financimit dhe ristrukturimit; Konsulence per transaksionet e financave te 2 korporatave;. Konsulence per blerjen, shitjet dhe vleresimet e kompanive; Studime te fizibilitetit, percaktimin e kerkesave financiare dhe identifikimin e instrumente mbrojtjes, analiza e kthimit ekonomik, analiza e vleresimit te asetave, patentat dhe markat tregtare, prokurimi, konsolidimin, transferin e biznesit know-how, promovimi i siper marrjeve te perbashketa; Promovimi dhe mbeshtetja e financimit te projekteve; Terheqjen e kapitalit privat per te ndertuar investimet ne interesin publik; Konsulence per fiskalitetin, sherbime kontabiliteti, pergatitjen e raporteve dhe deklarimet tatimore; Konsulence per legjislacionin tregtar te tatimit, prokurimin publik, koncesioneve, privatizimeve, per pronesine intelektuale dhe te drejtat e autorit, si dhe per ligjislacionin ne pergjithesi. Perfaqesimi i shoqerive tregtare, individuale ose ndonje entitet tjeter per procedura administrative ne Republiken e Shqiperise ose jashte saj. Konsulence per krijimin dhe zhvillimin ekonomik dhe financiar te shoqerive tregtare; Ndermjetesim, pajtim, mbeshtetje dhe negociim; Trajnime profesionale; Organizimi, takime, koordinim te seminareve, simpoziumeve, zhvillim i kurseve te studimit, trajnimit te stafit; Pergatitja e manualeve, buletineve te ndryshme, periodike dhe jo periodike, ne fushen e sherbimeve profesionale; Studim, hulumtim, implementim i teknologjise per impiante industriale, fabrikave dhe njesite e prodhimit, si ne Shqiperi dhe jashte vendit; Kompania do te marre dhe te pranoje agjencite dhe perfaqesuesit, duke perfshire edhe kompanite e huaja, ne sherbime dhe produkte te perpunuara. Kompania mund te kete pjesemarrje dhe interesa ne kompani te tjera qe kane qellime te ngjashme, analoge ose te ndryshme me te. Kompania mund te kryeje te gjitha



aktivitetet komerciale, industriale, financiare, per letra me vlere dhe pasuri te patundshme, te nevojshme per zbatimin dhe zhvillimin e korporatave. Kompania mund te marrin pjese direkt ose indirekt, tenderat, kontratat, ofertat ne sektoret publik dhe privat, ne lidhje me ofrimin e sherbimeve te pershkruara ne kete objekt. Kompania do te jete perfituesi i fondeve nga organizatat vendore dhe nderkombetare, publike dhe private, per aktivitetet e promovimit te biznesit dhe per zhvillimin e ndermarrjeve, si dhe per aktivite te tjera kane te bejne me korporatat. Per te kryer aktivitetet kompania do te mbeshtetet ne perkrahjen e profesionisteve te regjistruar ne listat profesionale, ne perputhje me dispozitat ligjore.

Neni 3:

Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e ushtrimit të aktivitetit të shoqërisë është e papërcaktuar duke filluar nga dita e regjistrimit në QKB, për njohjen dhe regjistrimin e shoqërisë si person juridik.

Neni 4:

Selia

Selia e shoqërisë “Yes RedGroup” SH.P.K është në **Rruga Ismail Qemali**, nd.14, H4, Ap 5, Tirane (njesia administrative nr 5.)

Kreu II

Kapitali

Neni 5

Kapitali themeltar

Kapitali Themeltar i shoqërisë është **100 000 Lekë (Njeqind mije)** formuar dhe nënshkruar nga ortakët i përbërë nga 1 kuotë si më poshtë:

- **Z.Pulici Paolo**, zotërues i **1 (Nje) kuote**, me pjesëmarrje në përqindje **100%** me një kontribut prej **100 000 Lekë (Njeqind mije)**

I depozituar dhe shlyer sipas ligjit në fuqi.

Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajshme/të paluajshme apo të drejta).

Ortakët kanë të drejtë në shpërndarjen e fitimeve (nëse ka fitime dhe kanë zbritur shumën që do përdoret si rezerva të detyrueshme të parashikuara nga ligji), në përpjesëtim me kuotat përkatëse.

Shoqëria përgjigjet vetëm me kapitalin e saj.

Neni 6:

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Kapitali themeltar mund të rritet duke nënshkruar kapitalin në përpjesëtim me kuotat përkatëse. Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

Neni 7

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- shitblerjes;
- trashëgimisë;
- dhurimit;
- çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Ortakët kanë të drejtë të transferojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, pjesërisht apo tërësisht dividendët e tyre e përfshirë dhe fondet dhe kontributet e pjesëve të kapitalit themelor, duhet të jenë të vërtetuara me Akt Noterial dhe për një gjë të tillë vendimet e asamblesë së ortakëve të shoqërisë duhet të merren paraprakisht me shkrim.

Shoqëria dhe të tretët duhet të respektojnë këto transferime sapo t'u bëhen të ditura.

KREU III


ORGANET VENDIMMARRËSE DHE DREJTUESE

Neni 8

Asambleja e Ortakëve

Asambleja e Ortakëve është Organi më i Lartë Drejtues dhe Vendimor i shoqërisë dhe ai ushtron të gjitha kompetencat që njihen nga ligji në fuqi. çështjet e mëposhtme:

1. përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
2. ndryshimet e statutit
3. emërimin e shkarkimin e administratorëve
4. emërimin e shkarkimin e likuiduesve;
5. përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "3" dhe "4" të kësaj pike;



6. mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
7. miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
8. zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
9. pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
10. përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
11. riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
12. miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
13. çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë. Përfaqësimi duhet të jepet me shkrim, qoftë edhe me prokurë të thjeshtë, dhe dokumentet përkatëse duhet të mbahen në regjistrimet e kompanisë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 9

Mbledhja


Administratori mund të thërrasë Asamblenë e Ortakëve kur e gjykon të përshtatshme dhe kur i kërkohet nga Aksioneri / Aksioneret në përputhje me Nenin 84 të Ligjit 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", ose anëtarët që përfaqësojnë të paktën 5 (pesë)% të totalit të votave të Asamblesë e Ortakëve.

Asambleja thirret me një njoftim që përmban ditën, orën dhe vendin e takimit, çështjet që do të diskutohen dhe, ndoshta, datën e thirrjes së dytë. Njoftimi i thirrjes komunikohet me letrën rekomande, ose me faks ose me e-mail në adresat e anëtarëve, të paktën 8 (tetë) ditë para datës së caktuar për mbledhje, afat që mund të jetë edhe më i shkurtër nëse miratohet nga shumica e anëtarëve, të cilët nuk kanë më pak se 50 % e vlerës nominale të kuotave.

Çdo ndryshim i mëposhtëm në adresën e e-mailit ose adresës së faksit të anëtarit duhet t'i njoftohet Administratorit me shkrim. Përndryshe, çdo njoftim drejtuar Ortakëve do të vazhdojë të ekzekutohet sipas të dhënave që Kompania ka në dispozicion dhe të cilat janë të deklaruara në këtë Statut dhe njoftimi do të konsiderohet i përfunduar.

Asambleja mund të zhvillohet me ndërhyrje të vendosura në më shumë se një vend, të afert ose të largët, audio ose video, me kusht që të respektohen mënyra kolegjiale dhe parimet e mirëbesimit dhe trajtimit të barabartë të anëtarëve. Në veçanti, do të jetë e nevojshme:

- Presidenti, gjithashtu përmes zyrës së tij, lejohet të konstatojë identitetin dhe legjitimitetin e të pranishmëve, të rregullojë ecurinë e takimit, të konstatojë dhe të shpall rezultatet e votimit;
- personi që merr procesverbalin lejohet që në mënyrë adekuate të perceptojë ngjarjet e takimit që i nënshtrohen procesverbalit;



- të pranishmit lejohen të marrin pjesë në diskutim dhe votim të njëkohshëm në pikat në rendin e ditës.

Neni 10

Kuorumi

Asambleja e ortakëve vendos në mënyrë të vlefshme në asamblenë e jashtëzakonshme, pas arritjes së kuoromit prej së paku 51% të anëtarëve të shoqërisë dhe asambleja vendos me së paku $\frac{3}{4}$ të votave të anëtarëve të pranishëm për çështjet e mëposhtme

- për ndryshimin e statutit;
- zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar;
- shpërndarjen e fitimeve;
- riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë:

Asambleja e ortakëve vendos në mënyrë të vlefshme në asamblenë e zakonshme për të gjitha çështjet e tjera, me arritjen e kuoromit prej së paku 51% dhe vendos me të paktën mbi gjysmën e numrit të përgjithshëm të votave të anëtarëve të pranishëm.

Nëse Asambleja e ortakëve nuk mund të përmbushë për shkak të mungesës së kuoromit të lartpërmendur, asambleja do të mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtën rend dite.

Neni 11

Emërimi i Administratorit

Adminstrator i shoqërisë është :

- **Z.Pulici Paolo, lindur në datë 15.05.1969 , në Desio/ Itali, madhor e me zotësi të plotë juridike për të vepruar , mbajtës i kartës së identitetit Italiane Nr. CA59673NJ .**


Afati i emërimit, është **5 vjet** i cili fillon nga momenti i depozitimit të këtij statuti në QKB dhe regjistrimit të shoqërisë .

Neni 12

Kompetencat e Administratorit

Administratori ka këto të drejta dhe detyra:

- të kryejë të gjitha veprimet në lidhje me administrimin e aktivitetit tregtar të kompanisë;
- përfaqëson kompaninë;
- mbajtjen korrekte të dokumenteve të kompanisë dhe të librave të kontabilitetit;



- përgatitjen dhe nënshkrimin e pasqyrave vjetore financiare, pasqyrave financiare të konsoliduara dhe raportet mbi ecurinë e aktivitetit, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve dhe sjelljen e këtyre dokumenteve në Asamble për miratim.
- të përfaqësojë kompaninë në mënyrë aktive ose pasive para çdo autoriteti gjyqësor, administrativ, fiskal në cilëndo procedurë në çdo fazë të gjykimit, si në Shqipëri ashtu edhe jashtë saj, me të drejtë të nënshkruajë çdo dokument ose dokument të kërkuar sipas rasteve, personalisht ose duke ndjekur formalitetet përkatëse, duke përfshirë prokurat, mandatet për avokatët, konsulentët ose palët e treta
- krijimi i një sistemi paralajmërues në kohën e duhur për çështjet që kërcënojnë mbarevajtjen e biznesit dhe ekzistencën e kompanisë
- të nënshkruajë kontrata të ndryshme për shitjen, blerjen, këmbimin ose dhënien me qira të pasurive të ndryshme (të luajtshme dhe të paluajtshme), si me personat fizikë dhe juridikë, vendas ose të huaj, ashtu edhe me Shtetin dhe në rast të blerjes së pronave të paluajtshme të bëjë transkriptimin e pronës së tij në favor të tij në zyrën "Hipotekë" dhe ZRPPP për të dokumentuar një rrethanë të tillë, si dhe një rritje në kapitalin e tyre në natyrë.
- të bëjë të gjitha llojet e veprimeve në të gjitha zyrat private dhe shtetërore, dhe në banka.
- të hap llogari bankare për shoqërinë pranë çdo banke të nivelit të dytë që operon në Republikën e Shqipërisë .
- të punësojë, pezullojë, shkarkojë dhe modifikojë kushtet që lidhen me marrëdhëniet e punësimit të stafit;
- të kryejë detyra të tjera të përcaktuara me ligj ose statut.

NENI 13

Përgjegjësitë e administratorit

Administratori është i detyruar të kompensojë shoqërinë për dëmet e pësuar, në rast se, në kundërshtim me dispozitat e ligjit nr. 9901 të datës 14/04/2008 dhe ndryshimet pasuese, kryen veprimet e mëposhtme.


- Kthimi i kontributeve për anëtarët
- Pagan interesa ose dividendë për anëtarët
- Shpërndan asetet e kompanisë
- I lejon kompanisë të vazhdojë aktivitetin tregtar, kur, bazuar në gjendjen financiare, pritët që kompania të mos ketë kapacitet paguese
- jep kredi

KREU IV

BILANCI, TË ARDHURAT DHE SHPËRNDARJA E KOMPANISË

NENI 14

Bilanci



Veprimet ekonomiko-financiare të kompanisë fillojnë në 1 Janar dhe mbyllen më 31 Dhjetor të çdo viti, me përjashtim të vitit të parë që fillon nga data e regjistrimit të kompanisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbyllet më 31 Dhjetor.

Rezultati i pasqyrave financiare vjetore duhet të përpilohet sipas rregullave të përcaktuara nga ligji i taksave dhe ai i kontabilitetit.

Pasqyrat financiare miratohen me rezolutë me shkrim të Asamblese së ortakëve, e cila gjithashtu vendos për disponueshmërinë e fondeve ligjore sipas nevojave të zhvillimit të mëtejshëm të shoqërisë, duke pasur parasysh fondin rezervë, fondin e veçantë etj.

NENI 15

Shkrirja dhe likuidimi

Kompania mund të shpërbëhet në çdo kohë, madje edhe para skadimit të afatit për të cilin është themeluar, për shkaqet e mëposhtme:

- Humbja e kapitalit dhe pamundësia e vazhdimit të mëtejshëm të aktivitetit;
- Për rastet e parashikuara nga ligji "Për falimentimin e shoqërive tregtare";
- Për shkak të përfundimit të afatit të përcaktuar për ushtrimin e veprimtarisë tregtare.

Në këtë rast, Asambleja e Ortakëve vendos me shkrim ku parashikon edhe likuidimin e kompanisë duke emëruar një ose më shumë likuidatorë dhe duke cituar në secilin dokument emërtimin e likuidatorit dhe shënimin shtesë "Kompani në Likuidim".

NENI 16


Çdo mosmarrëveshje apo konflikt që mund të lindë gjatë veprimtarisë së shoqërisë si rregull dhe në përgjithësi ortakët duhet ta zgjidhin atë me mirëkuptim. Përndryshe, çështja bëhet objekt i konfliktit gjyqësor në **Gjykatën e Rrethit Gjyqësor të Tiranës**.

NENI 17

Për çfarë nuk është parashikuar shprehimisht në këtë Statut, i bëhet referim dispozitave ligjore në fuqi për këtë temë.


NENI 18

Përmbajtja e këtij statuti është shkruar në 3 kopje identike, në gjuhën shqipe dhe, me miratimin nga ana e anëtarëve themelues të shoqërisë të çdo neni, nënshkruhet në të gjitha kopjet me emrin, mbiemrin dhe nënshkrimin origjinal.



THEMELUESI I SHOQËRISË TREGTARE

- **Z.Pulici Paolo**

A handwritten signature in blue ink, appearing to read 'Paolo Pulici', is written over the printed name. The signature is stylized and fluid.